

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 18, datë 19.5.2015

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË PRANIMIT DHE PROCEDURAVE TË REGJISTRIMIT NË SHKOLLAT E ARSIMIT PROFESIONAL

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 10, pika 1, të ligjit nr. 8872, datë 29.3.2002, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJMË:

I. Kriteret e pranimi

1. Në shkollat profesionale pranohen të gjithë individët që kanë përfunduar arsimin bazë dhe kanë marrë dëftesën e lirim.

2. Në klasën e dhjetë të shkollës profesionale publike pranohen nxënës të moshës jo më të madhe se tetëmbëdhjetë vjeç.

3. Deri në moshën njëzet e një vjeç, nxënësi lejohet të ndjekë arsimin e mesëm profesional katërvjeçar. Nxënësi, që ka mbushur moshën njëzet e dy vjeç, lejohet të vazhdojë vitin e katërt deri në fund të atij viti shkollor.

4. Shkolla publike profesionale, sipas kuotës së saj të pranimeve, ka të drejtë të pranojë nxënës edhe nga ato zona të tjera të vendit, kur në atë zonë nuk ka shkollë publike profesionale me një drejtim mësimor të caktuar.

5. Kur në shkollat publike profesionale ka kërkesa më të mëdha se numri i nxënësve të planifikuar, nxënësit përzgjidhen sipas mesatares më të lartë të notave të provimeve të lirim.

6. Kur me të njëjtën mesatare përfshihen më shumë nxënës nga sa mund të pranohen, drejtuesi i institucionit, pas këshillimit me bordin, shpall kriteret objektive e të matshme shtesë, si:

a) Mesatarja më e lartë e notës në njërin nga lëndët në provimet e lirim;

b) Nota më e lartë e nxënësve në testimin e tyre, me teste të hartuara, të administruara dhe të vlerësuara nga komisione të ngritura me urdhër të drejtuesit të shkollës. Përgjigjet e nxënësve ruhen një vit shkollor.

7. Përpara fillimit të regjistrimeve të reja, drejtuesit e shkollave profesionale, pasi konsultohen me bordet e tyre, planifikojnë për çdo drejtim mësimor:

a) Numrin e nxënësve;

b) Mesatare të veçanta për çdo drejtim.

8. Përpara fillimit të regjistrimeve të reja, drejtuesit e shkollave profesionale duhet t'i dërgojnë drejtuesit të çdo shkolle të arsimit bazë të zonës së vet dhe zonave të tjera:

a) Listën e lëndëve me zgjedhje që shkolla profesionale ofron;

b) Modelin e formularëve për t'u plotësuar nga nxënësit e klasës së nëntë.

9. Në shkollat profesionale publike nxënësit pranohen pa konkurs.

II. Procedurat e regjistrimit në shkollat profesionale

1. Shkollat profesionale publikojnë në një vend të dukshëm në mjediset e jashtme dhe në faqen e tyre të internetit, një muaj para datës së regjistrimit të nxënësve, këto të dhëna:

a) Kuotat e pranimeve të reja;

b) Afatet për paraqitjen e kërkesës për pranimin në shkollë;

c) Datat e regjistrimit.

2. Drejtuesi i shkollës profesionale publike njofton me postë elektronike dhe me shkresë zyrtare ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale, një muaj para datës së regjistrimit nxënësve, të dhënat e parashikuara në pikën 1 të këtij kreu.

3. Dokumentet për aplikim në shkollat profesionale, janë:
- a) Kërkesa për regjistrim, ku përcaktohet drejtimi mësimor që nxënësi do të ndjekë;
 - b) Kopje e noterizuar, e njehsuar me origjinalin e dëftesës së lirim;
 - c) Kopje e kartës së identitetit të nxënësit.
4. Si rregull, regjistrimi në shkollat publike profesionale përfundon para datës së fillimit të vitit shkollor.
5. Prindi ose nxënësi i regjistruar në një shkollë profesionale publike, që nuk paraqitet në shkollë në fillim të vitit mësimor, njofton drejtuesin e saj para fillimit të vitit mësimor.
6. Në bashkëpunim me njësitë arsimore vendore, shkollat profesionale publike organizojnë:
- a) Fushata promovuese mbështetur në platformën e rekomanduar nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale;
 - b) Takime të drejtuesve dhe të mësuesve të shkollave profesionale me nxënës të klasës së nëntë dhe me prindër të tyre.
7. Kur numri i kërkesave për pranim në një shkollë profesionale është më i madh se kapaciteti i shkollës, drejtuesi i saj i dërgon ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale dhe Kryetarit të këshillit të njësisë përkatëse të qeverisjes vendore, kërkesën me shkrim për shtimin e kapaciteteve të shkollës.
- Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË
Erjon Veliaj

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla